



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 540 Akti**

**Nr. 571 Vendimi**  
**Tiranë, më 12.10.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Brunilda Bekteshi** Kryesuese  
**Roland Ilia** Relator  
**Pamela Qirko** Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 10.10.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Deniona Katro**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Deniona Katro, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Deniona Katro, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin qershor të vitit 2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Deniona Katro do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, komisionere Brunilda Bekteshi, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Deniona Katro.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Deniona Katro nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**8.** Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua akti i kontrollit nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2018, i ILDKPKI-së, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\*, datë 9.10.2018, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Deniona Katro, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**9.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.7.2022, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**10.** KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe nga të dhënat arkivore të këtij Këshilli. Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2022, i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2022.

**11.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

**12.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e vlerësimit - vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Deniona Katro; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**13.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 26.9.2022 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti, pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 29.9.2022.

**14.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 5.10.2022, vendosi të ftojë znj. Deniona Katro në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**15.** Subjekti i rivlerësimit Deniona Katro u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 5.10.2022.

**16.** Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 10.10.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

**17.** Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Deniona Katro kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**18.** Zj. Deniona Katro ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**19.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**20.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**20.1** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**20.2** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**20.3** Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

### A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë referuar neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2018, ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit Deniona Katro, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

---

<sup>1</sup>“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

24. Znj. Deniona Katro është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2008, me numër indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2008; (ii) periodike/vjetore, për vitet 2008 – 2016; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

## **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

26. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Deniona Katro, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi \*\*\*, datë 19.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2008 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Deniona Katro ka deklaruar pasuritë, si vijojnë:

### **1. Apartament banimi me sip. 86 m<sup>2</sup>, Durrës**

1.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Apartament banimi, me sip. 86 m<sup>2</sup>, në lagjen nr. \*\*\*, rruga ‘\*\*\*’, nr. \*\*\*, Durrës. Është bërë rivlerësimi i pasurisë në datën 29.2.2012, për shumën 4.487.308 lekë*”.

**1.2** Burimi i krijimit: dhuruar nga prindërit, të cilët e kanë përfitur me kontratë dhurimi nga ish - \*\*\* Durrës (i ndërtuar me punë vullnetare), ku babai i subjektit ka punuar dhe është regjistruar fillimisht në regjistrat hipotekore në datën 22.2.1995. Pjesa takuese: 100%.

**1.3** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues për këtë pasuri<sup>2</sup>.

**1.4** ZQRPP-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Durrës, e cila konfirmon se shtetasja Deniona Katro ka në pronësi<sup>3</sup> një apartament me vendndodhje në z. k. \*\*\*. Sipas kartelës, pasuria është rivlerësuar fillimisht në shumën 4.487.308 lekë dhe në datën 28.6.2017, në shumën 6.800.000 lekë.

**1.5** Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “Dhuruar nga prindërit apartament me sip. 86 m<sup>2</sup>, në të cilin banojmë prej rreth 20 vjetësh, i ndodhur në lagjen nr. \*\*\*, rruga ‘\*\*\*’, nr. \*\*, Durrës. Kontrata nr. \*\*, datë 7.3.2012. Bërë vlerësimi nga ZVRPP-ja Durrës, sipas kërkesës së datës 7.2.2012, vlera 4.487.308”. Subjekti bashkëlidhur DPV-së ka paraqitur kontratë dhurimi + vërtetim hipotekor.

**1.6** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se që nga dita e emërimit kam banuar në shtëpinë time, apartamentin në adresën e mësipërme. Pronarë të objektit fillimisht kanë qenë prindërit e mi, pastaj në vitin 2012 ma kanë dhuruar mua.

**1.7** Komisioni hetoi edhe për prindërit e subjektit, të cilët janë persona të tjerë të lidhur në cilësinë e dhuruesit të pasurisë apartament. Konkretisht, Komisioni hetoi në lidhje me faktin e krijimit të kësaj pasurie dhe burimeve të ligjshme, si dhe nëse ata kanë krijuar, disponojnë apo përdorin pasuri të tjera përveç apartamentit ku jetojnë së bashku me subjektin. Nga hetimi i kryer, rezultoi se kjo pasuri është përfitur nga prindërit e subjektit shumë vite para se subjekti të fillonte detyrën si magjistrate. Gjithashtu, nga përgjigjet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe DPSHTRR-ja nuk konstatoi që prindërit e subjektit të kenë krijuar pasuri të tjera përgjatë viteve 2008 – 2016.

**1.8** Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI, përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Durrës, si dhe përgjigjet për efekt hetimi të administruara nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka bërë deklarinim të saktë në lidhje me këtë pasuri.

---

<sup>2</sup>Shihni dokumentet bashkëlidhur deklaratës *Vetting* në dosjen e ILDKPKI-së: *Certifikatë për vërtetim pronësie lëshuar më datë 12.12.2012, për pasurinë “apartament”, me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>, regjistruar me \*\*\*, në emër të Deniona Katro; Harta treguese e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme; kontratë dhurimi “apartament” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.3.2012, me palë dhuruese S.K dhe palë pranuese të dhurimit Deniona Katro, të një apartamenti me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Durrës, lagje nr. \*\*, z. k. \*\*, regjistruar me nr. \*\*. Gjithashtu, P. K jep pëlqimin për dhurimin e apartamentit vajzës së saj Deniona Katro; vërtetim nga dokumentet hipotekor nr. \*\*, datë 22.2.1995, lëshuar më datë 8.3.2012, të pasurisë me nr. \*\*, në emër të S. K, shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit dhe certifikatën familjare të S. K; kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.2.1995, nënshkruar ndërmjet palës dhuruese E.M, në cilësinë e përfaqësuesit të \*\*\* Durrës dhe palës pranuese të dhurimit S.K, të një apartamenti me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>; vërtetim pronësie datë 22.2.1995; autorizim nr. \*\*, datë 10.12.1991, për strehimin e z. S.K, në banesën e \*\*\* dhe vërtetim nr. \*\*\* rep., datë 25.10.2016.*

<sup>3</sup>Shihni dokumentacionin bashkëlidhur përgjigjes së ZQRPP-së në dosjen e ILDKPKI-së.

## 2. Automjet tip “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2016

2.1 Subjekti ka deklaruar automjet tip “\*\*\*\*”, viti 2006, me targa AA \*\*\*, me vlerë 4,000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna ndër vite. Zotërimi: 100%.

2.2 Për këtë, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentet justifikues ligjor<sup>4</sup>.

2.3 DPSHTRR-ja, me shkresat nr. \*\*\*, datë 18.7.2017 dhe nr. \*\*\*, datë 27.7.2017, konfirmon në emër të shtetasës Deniona Katro automjetin me targa AA \*\*\*. Bashkëlidhur ndodhet dosja e automjetit e cila përmban kontratë shitje pasurie të luajtshme (autoveturë) nr. \*\*\*, datë 11.10.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse L.D dhe palës blerëse Deniona Katro, të automjetit tip “\*\*\*\*”, me targa AA \*\*\*, në vlerën 4,000 euro.

2.4 Në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar: “Automjet, lloji autoveturë, tip ‘\*\*\*\*’, vit prodhimi 2006, me targa AA \*\*\*, kontratë nr. \*\*\*, datë 11.10.2016, me vlerë 4,000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna”.

2.5 DPSHTRR-ja, në përgjigje të hetimit nga Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2022, konfirmon se shtetasja Deniona Katro ka pasur të regjistruar në emrin e vet automjetin tip “\*\*\*\*” me targa AA \*\*\*<sup>5</sup>, të blerë në vitin 2016 në vlerën 4,000 euro.

## 2.6 Analiza financiare

### Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*”, në vlerën 4,000 euro, më 11.10.2016

PËRSHKRIMI	VLERA
Të ardhura nga pagat e subjektit 1.1.16 - 11.10.16	1,015,960
Shpenzime jetese 1.1.16 - 11.10.16	186,115
Shpenzime udhëtimi 1.1.16 - 11.10.16	103,520
Blerje automjeti tip “****”, datë 11.10.2016 - 4,000 euro	541,080
Ndryshim likuiditeti 31.12.2015 - 11.10.2016	-123,133
<b>Mundësia financiare për blerje automjeti</b>	<b>308,378</b>

Komisioni, pasi analizoi mundësinë e blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*” në vlerën 4,000 euro në vitin 2016, me burim nga të ardhurat nga puna, konstatoi se subjekti kishte mundësi për blerjen e kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve të atij viti.

2.7 Deklarimi i bërë në deklaratën *Vetting*, në DPV-në e vitit 2016 dhe dokumentacioni justifikues ligjor i dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, përputhen me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja, për këtë pasuri automjet.

<sup>4</sup>Shihni dokumentet në aneksin \*\*\*, bashkëlidhur deklaratës në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>5</sup>Bashkëlidhur DPSHTRR-së ka sjellë dokumentacionin: leje qarkullimi rrugor; kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 11.10.2016 me blerës Deniona Katro; kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 26.6.2021, me shitës Deniona Katro, etj.



**2.8** Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri dhe ka pasur burime të ligjshme për krijimin e saj, gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga germa “a” e pikës 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **3. Llogari rrjedhëse e subjektit në “Raiffeisen Bank”**

**3.1** Subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, ku derdhet paga, me gjendje 406.802 lekë. Zotërimi: 100%.

**3.2** “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2017, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka llogari page me gjendje 406,652 lekë.

**3.3** Nga hetimi i Komisionit, “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\*, datë 27.6.2022, konfirmon llogari page në emër të subjektit Deniona S Katro me gjendje llogarie 406,802.67 lekë, datë 11.1.2017.

**3.4** Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika referuar deklaramit të subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga “Raiffeisen Bank”.

### **4. Depozitë bankare në “Veneto Bank”**

**4.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, depozitë bankare në “Veneto Bank”, transferuar shuma nga “ProCredit Bank”, ku janë derdhur lekët nga mësimdhënia pranë A.U. Vlera: 336,239 lekë. Zotërimi: 100%.

**4.2** Subjekti ka deklaruar këtë depozitë bankare në DPV-në e vitit 2016, vit kur ka bërë transferimin e shumës monetare nga ProCredit Bank (llogari page e periudhës 1.1.2010 - 20.10.2016) në “Veneto Bank”, të shumës 336,239 lekë.

**4.3** “Veneto Bank”, me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.7.2017, ka konfirmuar se subjekti ka depozitë në vlerën 336,239 lekë.

**4.4** Në përgjigje të “Intesa Sanpaolo Bank” (e cila ka blerë “Veneto Bank” në vitin 2018) konfirmohet llogaria depozitë në emër të shtetases Deniona Katro tek ish “Veneto Bank” në vitin 2016, me gjendje në vlerën 336,239.28 lekë. Kjo depozitë buron nga llogaria tek ish “Veneto Bank”, e krijuar nga transferimi i së njëjtës vlerë nga “ProCredit Bank” me datë 29.1.2016, e konfirmuar kjo nga statement bankar i “ProCredit Bank”, që vjen me përgjigje ndaj Komisionit në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2022. Burimi i gjendjes së likuiditeteve të “ProCredit Bank” janë pagat nga mësimdhënia tek A.U.

**4.5** Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika referuar dokumentacionit të dorëzuar si dhe përgjigjes së “Veneto Bank”.

### **5. Kursime nga të ardhurat**

**5.1** Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “Gjendje cash në shtëpi 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna ndër vite”.

5.2 Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* për herë të parë në vitin 2008 (në deklaratën para fillimit të detyrës si prokurore) *para cash në shtëpi, të kursyera 100,000 lekë*.

5.3 Në DPV-në e vitit 2008 ka deklaruar *kursime nga paga të ruajtura në shtëpi 200,000 lekë*.

5.4 Në DPV-të e viteve 2009, 2010, 2011 dhe 2012 subjekti nuk deklaroi ndryshimin (shtesa apo pakësime) e kursimeve *cash*.

5.5 Në DPV-në e vitit 2013 subjekti deklaroi *lekë cash në shtëpi, të tërhequra nga llogaria në "Raiffeisen Bank", si edhe të ndodhura në këtë llogari 300,000 lekë*.

5.6 Në DPV-në e vitit 2015 subjekti deklaroi *shtuar 100 euro nga një seminar në Kroaci dhe shtuar 1,300 euro (shtëpi cash) nga shitja e automjetit me targa DR \*\*\**.

5.7 Në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar *kursime nga paga cash në banesë 210,000 lekë*.

5.8 Duke parë deklaratimet ndër vite të subjektit, referuar ligjit nr. 9049/2003, "Për deklarinimin e pasurisë ...", i ndryshuar, rezultoi se subjekti ka krijuar likuiditete në formë kursime *cash* deri në fund të vitit 2016, në vlerën 1,002,710 lekë (duke përfshirë kursimet në lekë dhe euro).

5.9 Subjekti u pyet për gjendjen *cash*, e cila, në përgjigje të pyetësorit<sup>6</sup>, saktësoi krijimin dhe ndryshimin e gjendjes *cash*, ndër vite.

5.10 Nga përgjigjja e subjektit, në lidhje me krijimin e gjendjes *cash* rezultoi se deklarimi i subjektit i bërë në deklaratimet periodike vjetore përputhet me gjendjen e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

5.11 Komisioni vlerësoi mbi gjendjen progresive të kursimeve *cash*, bazuar në këto deklarata periodike ndër vite.

5.12 Në funksion të vlerësimit të kursimeve *cash* të subjektit, është analizuar mundësia e krijimit të gjendjes *cash* prej 100,000 lekësh, të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2008.

#### **Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve cash në vlerën 100,000 lekë deri më 1.8.2008**

PËRSHKRIMI	VLERA
Të ardhura subjekti tetor 1999 – 31.7.2008	4,104,136
Shpenzime jetese tetor 1999 – 31.7.2008	937,099
Automjeti tip "****", blerë në vitin 2006	500,000
Kursime <i>cash</i>	100,000
<b>Mundësia financiare</b>	<b>2,567,037</b>

5.13 Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2008, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës.

5.14 Komisioni analizoi edhe mundësinë e shtesës së kursimeve *cash* të deklaruar në DPV-në e vitit 2008 në vlerën 200,000 lekë nga data e emërimit (1.8.2008) deri në datën 31.12.2008. Nga analiza

<sup>6</sup>Shihni përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin nr. 2 në dosjen e Komisionit.

financiare e harkut kohor 1.8.2008 – 31.12.2008 rezultoi se subjekti kishte mundësi financiare për shtimin e kursimeve *cash* dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës.

**5.15** Lidhur me mundësitë financiare për krijimin e këtyre kursimeve *cash* për vitet 2008 – 2016, referojuni tabelës së analizës financiare në pikën 7 të këtij vendimi.

**5.16** Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika dhe rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë në DPV-të dhe në deklaratën *Vetting* për kursimet *cash* në vitin 2008 dhe burimin e tyre.

## **6. Konstatime të tjera**

**6.1** Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010: *“Automjet tip ‘\*\*\*’, me targa DR \*\*\*, blerë në vitin 2010, pagesa e doganës dhe detyrimet ndaj DRSHTRR-së Durrës. Faturë blerje në Itali nr. \*\*\*, datë 7.4.2010, e ‘C.A.B.A’ – 1,500 euro, 270,000 lekë dogana dhe taksat”*.

**6.2** DPSHTRR-ja konfirmon me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2022, automjetin tip “\*\*\*\*”, me targa DR \*\*\*, në emër të subjektit Deniona Katro. Bashkëngjitur është dosja e automjetit, ku rezulton faturë në Itali, lëshuar nga C.A.B.A me nr. \*\*\*, datë 7.4.2010, me vlerë shitje 1,500 euro, ku blerësi është subjekti Deniona Katro. Gjithashtu, me deklaratën doganore \*\*\*, datë 10.4.2010, konfirmohet importi i këtij automjeti me importues Deniona Katro, me vlerë 1,500 euro dhe me total të detyrimeve doganore në vlerën 244,438 lekë.

**6.3** Sipas dokumentacionit të gjendur në dosjen e DPSHTRR-së, automjeti është shitur nga subjekti me kontratën nr. \*\*\*, të datës 23.6.2015, në vlerën 1,300 euro.

**6.4** Subjekti, në DPV-në e vitit 2015, ka deklaruar: *“Shitur automjeti tip ‘\*\*\*’, klasi \*\*\*, me targa DR\*\*\*. Shtuar 1,300 euro (shtëpi cash)”*.

**6.5** Komisioni analizoi mundësinë e blerjes së këtij automjeti me datë 10.4.2010 dhe nga analiza financiare rezultoi se subjekti nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” në vitin 2010 dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës në vlerën 256,962 lekë.

**6.6** Në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**6.7** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e dorëzuara në Komision, parashtroi se: *“Pasi u njoha me rezultatet e hetimit administrativ, konstatova se kam barrën e provës në lidhje me blerjen e një automjeti tip ‘\*\*\*’, me targa DR \*\*\*, blerë në vitin 2010 (blerje në Itali datë 7.4.2010, në vlerën 1,500 euro dhe 270,000 lekë dogana dhe taksat), nga ku ka rezultuar se kam qenë në pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti në vlerën 256,962 lekë.*

*Në vijim të qenies tërësisht e vërtetë dhe e sinqertë në përgjigjet e mia në këtë proces, them se nuk mbaj mend se çfarë ka ndodhur, por e vetmja përgjigje që unë kam për ju dhe që jam e bindur që kështu ka ndodhur, është që unë kam përdorur kursimet e mia cash dhe gjatë vitit i kam zëvendësuar ato nga pagat dhe nga shitja e mjetit tip ‘\*\*\*’.*

Të vetmet të ardhura të miat, deri më sot, kanë pasur si burim pagat e mia nga puna (dhe disa vite mësimdhënie). Siç edhe ju kam kthyer përgjigje në pyetësonin nr. 2, unë kam pasur 300,000 lekë kursime në banesë, të cilat kanë qenë të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

Gjithashtu, unë nuk kam deklaruar kursime për vitin 2010, por kam zëvendësuar ato që kam shpenzuar për blerjen e automjetit”.

**6.8** Pas vlerësimit të përgjigjeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit lidhur me pamundësinë financiare të blerjes së automjetit në vitin 2010, Komisioni analizoi mundësinë e blerjes së automjetit në vitin 2010, duke përfshirë si burim edhe gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruara në fund të vitit 2009, në vlerën 300,000 lekë.

**6.9** Për këtë Komisioni hartoi analizën financiare përfundimtare lidhur me mundësinë e subjektit për blerjen e kësaj pasurie.

**Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*” në vlerën 1,500 euro + 270,000 lekë, më 10.4.2010**

PËRSHKRIMI	VLERA
Të ardhura nga pagat subjekti 1.1.2010 - 10.4.2010	278,247
Të ardhura nga mësimdhënia 1.1.10 - 10.4.2010	27,000
<b>Të ardhura totale 1.1.2010 - 10.4.2010</b>	<b>305,247</b>
Shpenzime jetese 1.1.2010 - 10.4.2010	39,848
Blerje automjeti tip “****” datë 10.4.2010	478,215
Ndryshim likuiditeti 31.12.2009 - 10.4.2010	-255,854
<b>Mundësia financiare për blerje automjeti</b>	<b>43,038</b>

**6.10** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte mundësi financiare të mjaftueshme për blerjen e automjetit datë 10.4.2010 dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës.

**6.11** Nisur nga fakti se në DPV-në e vitit 2010 subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të kursimeve *cash*, Komisioni vlerësoi se gjendja e këtyre kursimeve në fund të vitit 2010 është e njëjtë me atë të vitit 2009, pra në vlerën 300,000 lekë.

**6.12** Komisioni analizoi edhe mundësinë e subjektit për zëvendësimin e kursimeve *cash* nga data 10.4.2010 deri në datën 31.12.2010, sipas përgjigjes së saj mbi rezultatet e hetimit, duke hartuar analizën financiare si në vijim.

**Analiza e mundësisë së shtimit të kursimeve *cash* 300,000 lekë për harkun kohor 10.4.2010 - 31.12.2010**

<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>VLERA</b>
Të ardhura nga pagat subjekti 11.4.2010 - 31.12.2010	576,049
Të ardhura nga mësimdhënia 11.4.2010 - 31.12.2010	157,500
<b>Të ardhura totale 11.4.2010 - 31.12.2010</b>	<b>733,549</b>
Shpenzime jetese 11.4.2010 - 31.12.2010	96,773
Shpenzime udhëtimi 11.4.10 - 31.12.2010	149,422
Ndryshim likuiditeti 10.4.10 - 31.12.2010	397,984
<b>Mundësia financiare për shtim kursime <i>cash</i></b>	<b>89,370</b>

**6.13** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti, deri në fund të vitit 2010, kishte mundësi financiare për zëvendësimin e kursimeve *cash* të përdorura për blerjen e automjetit.

**6.14** Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika dhe rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet dhe ndryshimin e kursimeve *cash* ndër vite.

## **7. Analiza financiare**

**7.1** Në përfundim të hetimit Komisioni hartoi analizën financiare për subjektin e rivlerësimit Deniona Katro, sipas tabelës në vijim.

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: Deniona S. Katro										
PERSHKRIMI	01.08.08 - 31.12.08	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
<b>PASURI</b>	<b>193,917</b>	<b>92,800</b>	<b>620,345</b>	<b>7,589</b>	<b>126,505</b>	<b>390,642</b>	<b>110,329</b>	<b>322,626</b>	<b>682,716</b>	<b>2,547,470</b>
Apartament 86 m2 Rr. ***, Durrës - 100%										0
Automjet *** - 2010			478,215							478,215
Automjet *** - 4,000€ - 100%									541,080	541,080
<b>Ndryshim ne likuiditet</b>	<b>193,917</b>	<b>92,800</b>	<b>142,130</b>	<b>7,589</b>	<b>126,505</b>	<b>390,642</b>	<b>110,329</b>	<b>322,626</b>	<b>141,636</b>	<b>1,528,175</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
										0
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>193,917</b>	<b>92,800</b>	<b>620,345</b>	<b>7,589</b>	<b>126,505</b>	<b>390,642</b>	<b>110,329</b>	<b>322,626</b>	<b>682,716</b>	<b>2,547,470</b>
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>357,731</b>	<b>774,011</b>	<b>1,033,314</b>	<b>942,006</b>	<b>996,526</b>	<b>854,029</b>	<b>1,034,975</b>	<b>1,389,465</b>	<b>1,287,491</b>	<b>8,669,548</b>
Të ardhura nga pagat subjekti D. K.	357,731	774,011	1,033,314	942,006	840,026	854,029	1,034,975	1,210,520	1,287,491	8,334,103
Të ardhura nga shitja e automjetit ***								178,945		178,945
Të ardhura nga dëmshpërblim *** - 2012					156,500					156,500
<b>SHPENZIME</b>	<b>56,925</b>	<b>246,356</b>	<b>286,042</b>	<b>320,559</b>	<b>177,272</b>	<b>183,087</b>	<b>377,899</b>	<b>327,514</b>	<b>338,612</b>	<b>2,314,266</b>
Shpenzime jetese	56,925	136,620	136,620	136,620	139,548	141,024	219,998	224,276	235,092	1,426,723
Shpenzim riparim automjet *** - 2012							156,500			156,500
Shpenzime udhëtimi	0	109,736	149,422	183,939	37,724	42,063	1,401	103,238	103,520	731,043
<b>Analiza e dokumentuar</b>	<b>106,889</b>	<b>434,855</b>	<b>126,927</b>	<b>613,858</b>	<b>692,749</b>	<b>280,300</b>	<b>546,747</b>	<b>739,326</b>	<b>266,163</b>	<b>3,807,811</b>
							<b>Pamundësia financiare totale</b>			<b>0</b>

**7.2** Bazuar në analizën financiare, rezultoi se subjekti kishte mundësi financiare për shtimin e pasurive të saj dhe mbulimin e shpenzimeve të saj nga data e fillimit të detyrës deri në fund të vitit 2016.

## **8. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare**

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

- a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “ProCredit Bank”, “Raiffeisen Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank”, “Alpha Bank”, ish “Veneto Bank” dhe deklarimeve të kursimeve *cash* në deklaratat periodike vjetore.
- b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:
  - i) të ardhurat nga pagat e subjektit si: juriste tek EKB-ja (1999 – 2001); OPGJ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (2001 – 2008), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës (2008 – 2016); dhe si pedagoge pranë A.U, Tiranë (2009 – 2013);
  - ii) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “\*\*\*\*”, me targa DR \*\*\* (2015);
  - iii) të ardhurat nga dëmshpërblimi I (2012).
- c. Shpenzimet, ku përfshihen:
  - i) shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i);
  - ii) shpenzimet për riparimin e automjetit të aksidentuar me targa DR \*\*\* (2012);
  - iii) shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (J.R.), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.
- ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive<sup>7</sup>.

**Për sa më sipër, trupi gjykues, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit rezultoi se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016.**

---

<sup>7</sup>Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Deniona Katro, me anë të verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin përfundimtar<sup>8</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Deniona Katro, ku ka konstatuar se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Deniona Katro.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elementë që vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke përfshirë edhe lëvizjet e subjektit për hyrje-daljet jashtë vendit sipas informacionit<sup>9</sup> nga sistemi *TIMS*.

Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Deniona Katro ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Ky raport është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Është bërë përshkrimi dhe analizimi i dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Deniona Katro, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky raport i ka analizuar të dhënat e

<sup>8</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2022.

<sup>9</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2022, të DPPSH-së.



rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: aftësitë profesionale; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, etj.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, si dhe të dhënave në arkivin e Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Deniona Katro, nga nëntori i vitit 2016 dhe deri aktualisht ushtron detyrën e prokurores, zv/drejtueses dhe Drejtueses së Njesisë së Përbashkët Hetimore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga muaji korrik i vitit 2016 deri në nëntor të vitit 2016 subjekti i rivlerësimit Deniona Katro ka ushtruar detyrën e prokurores, zv/drejtueses dhe Drejtueses së Njesisë së Përbashkët Hetimore (komanduar) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga muaji prill i vitit 2014 deri në korrik të vitit 2016 ka ushtruar detyrën e prokurores (komanduar) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga muaji maj i vitit 2013 deri në prill të vitit 2014 ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga muaji prill i vitit 2010 deri në maj të vitit 2013 ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme, komanduar në Drejtorinë e Kontrollit të Hetimeve. Nga muaji prill i vitit 2010 deri në maj të vitit 2013 ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme, komanduar në Drejtorinë e Kontrollit të Hetimeve.

Nga muaji gusht i vitit 2008 deri në prill të vitit 2010 ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga muaji janar i vitit 2001 deri në korrik të vitit 2008 ka ushtruar detyrën e oficerës së policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Subjekti i rivlerësimit Deniona Katro ka deklaruar se gjatë tri viteve të fundit ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës penale, materiale dhe procedurale.

Për sa i përket të dhënave statistikore, prokurorja Deniona Katro ka deklaruar se gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 të ushtrimit të detyrës i janë caktuar gjithsej 57 procedime penale dhe 47 materiale kallëzuese, të gjitha të përfunduara.

## **Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurore Deniona Katro, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, nga të cilat dy dokumente të llojit “kërkesë për gjykim” dhe një dokument i llojit “kërkesë për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit”.

Nga verifikimi i dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti, konstatohen këto gjetje:

### **1. Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 11.10.2013”**

Subjekti i rivlerësimit Deniona Katro, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka përpiluar kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, kundër të pandehurve: B.B etj., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese” ndaj dy ose më shumë personave, kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, pasi ka shkaktuar vdekjen e shtetasit A.B dhe plagosjen e shtetasve F. B dhe V. B, si dhe veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga nenet 79/dh-22 e 25 dhe 278/4 të Kodit Penal; Gj.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese” ndaj dy ose më shumë personave, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, pasi ka shkaktuar vdekjen e shtetasit A. B dhe plagosjen e shtetasve F. B dhe V. B, parashikuar nga nenet 79/dh-22 dhe 25 të Kodit Penal; E.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal; Gj.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykim” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese-arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën konkluduese, prokurorja parashtron disponimin e saj, bazuar në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale, duke kërkuar gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2013 në ngarkim të të pandehurve.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkuese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Rezulton se në kërkesë pasqyrohen rrethanat e faktit penal, megjithatë në të i kushtohet më shumë rëndësi paraqitjes së hollësishme të përmbajtjes së provave.

Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar shkaqet ligjore të kërkesës për gjykim. Baza ligjore e kërkesës për gjykimin e procedimit penal, neni 331, është identifikuar drejt.

### **2. Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 1.12.2015”**

Subjekti i rivlerësimit Deniona Katro, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka përpiluar kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, kundër të pandehurve: H.R, akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal; P.Xh, akuzuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal; E.M, akuzuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre” kryer në bashkëpunim dhe “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248, 25 dhe 186/3, 25 të Kodit Penal; F.L, akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/3 dhe 25 të Kodit Penal; F. B, akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/3

dhe 25 të Kodit Penal; M.T, akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal; N.TH, akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal; A.M, akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal; A.S, akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Rezulton se në kërkesë pasqyrohen rrethanat e faktit penal, megjithatë në të i kushtohet më shumë rëndësi paraqitjes së hollësishme të përmbajtjes së provave.

Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar shkaqet ligjore të kërkesës për gjykim. Në këtë kërkesë, konkluzioni i prokurorit në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf.

### **3. Dokumenti ligjor “kërkesë për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit”, datë 21.3.2014**

Subjekti i rivlerësimit Deniona Katro, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka përpiluar kërkesën për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit, datë 21.3.2014, për të ndaluarin E.F, i ndaluar për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor “kërkesë për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit” është i strukturuar dhe i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Rezulton se në kërkesë pasqyrohen rrethanat e faktit penal, megjithatë në të i kushtohet më shumë rëndësi paraqitjes së hollësishme të përmbajtjes së provave. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar shkaqet ligjore të kërkesës për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit. Në këtë kërkesë, konkluzioni i prokurorit në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf. Baza ligjore e kërkesës për gjykimin e procedimit penal, neni 238, është identifikuar drejt.

### **Përshkrimi i pesë dosjeve për prokuroren Deniona Katro, të përzgjedhura me short**

Prokurorja Deniona Katro, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 22 materiale për mosfillimin e procedimit penal, 4 materiale për pushimin e procedimit penal, 6 procedime për dërgimin e çështjes në gjyq dhe 14 çështje për pezullimin e hetimit.

Nga shorti i hedhur rezulton se u përzgjedhën në mënyrë rastësore një vendim mosfillimi, dy vendime pushimi dhe dy vendime për dërgimin e çështjes për gjykim.

### **Gjetjet nga vëzhgimi/shqyrtimi i pesë dosjeve përshkruhen si në vijim:**

**Dosja 1** – dokumenti ligjor, vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 7.3.2014, për kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 10.3.2014

Në mbështetje të germës “ç”, të pikës 1, të neneve 24/2, 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 17.3.2014 subjekti i rivlerësimit, prokurore Deniona Katro, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\*, datë 10.3.2014, etj.”.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Përgjithësisht akti është i arsyetuar. Në këtë vendim, konkluzioni i prokurores, në aspektin arsyetues lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë brenda afatit 30-ditor i parashikuar në udhëzimin nr. \*\*\*, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. \*\*\*, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’ i ndryshuar”, i Prokurorit të Përgjithshëm.

**Dosja 2** – vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2013”, datë 18.12.2013, hartuar nga prokurorja Deniona Katro, subjekt rivlerësimi, për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me vendimin datë 18.12.2013, subjekti Deniona Katro, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në bazë të germës “dh”, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur “Pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2013 etj.”.

Kallëzuesi M.I ka kundërshtuar vendimin e pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës në gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.7.2014, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të vendimit të pushimit, datë 18.12.2013”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në vendim argumentohet se në kushtet kur të dy shtetasit pranojnë se kanë pasur komunikime të vazhdueshme për shkak të shoqërisë së tyre, ku dhënia e parave dhe bisedat mes të dyve janë bërë pa dijeninë e asnjë personi tjetër (sipas deklaratimit të kallëzuesit), pra nuk ka dëshmitarë për një fakt të tillë dhe duke qenë se shtetasi S.B e mohon faktin që t’i ketë premtuar kallëzuesit se do ta çojë në Angli apo t’i ketë marrë para, nuk mund të provohet ekzistenca e faktit penal. Neni 4 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit, pra dyshimet në lidhje me faktin penal shkojnë në favor të shtetasit S.B.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Rezulton se në vendim pasqyrohen rrethanat e faktit penal dhe provave të administruara për efekt të hetimit të çështjes penale.

Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes. Baza ligjore e vendimit të pushimit të procedimit penal, germa “dh” e nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, është identifikuar drejt.

**Dosja 3** – procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 19.7.2010, për kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, dokumenti ligjor në përfundim të hetimeve, vendim “Për pushimin e çështjes penale”, datë 27.1.2013, përgatitur nga prokurorja Deniona Katro, subjekt rivlerësimi.

Në datën 19.7.2010 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”. Në datën 1.11.2011 është vendosur pezullimi i hetimeve të këtij procedimi penal në pritje të letërporosisë nisur autoriteteve gjyqësore italiane. Në datën 20.4.2011 është vendosur rifillimi i hetimeve, pasi më 15.4.2011 është përcjellë përgjigjja e letërporosisë. Në datën 1.6.2011 është vendosur përsëri pezullimi i hetimeve të këtij procedimi penal në pritje të letërporosisë së dytë nisur autoriteteve gjyqësore italiane. Më 27.6.2013 është vendosur rifillimi i hetimeve, pasi me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2013, të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë pranë Prokurorisë së Përgjithshme është përcjellë përgjigjja e letërporosisë së dërguar nga ana e Komisionit autoriteteve gjyqësore italiane.

Në datën 27.11.2013 subjekti i rivlerësimit Deniona Katro ka përpiluar “Vendimin për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2010”, në mbështetje të germës “a”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, ku ka vendosur:

1. Të pushojë hetimet e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2010.
2. Me këtë vendim të njohë të dëmtuarit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ose te prokurori më i lartë.

Dokumenti ligjor “Vendim pushimi” është i strukturuar, i ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe pjesa konkluduese.

Baza ligjore e identifikuar është e saktë, duke u bazuar në vlerësimin e faktit penal nga subjekti i rivlerësimit.

Në vendim prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes së palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë, sipas nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit Deniona Katro, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

**Dosja 4** – kërkesë “Për gjykimin e çështjes”, datë 6.3.2014, përgatitur nga prokurorja Deniona Katro, subjekt rivlerësimi, me të pandehur M. K, akuzuar për veprën penale “drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 6.3.2014.

Subjekti i rivlerësimit Deniona Katro, në datën 8.1.2014, bazuar në nenet 287 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe emrin e shtetasit M.K si person nën hetim. Mbështetur në nenin 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurorja Deniona Katro, në datën 6.3.2014 ka marrë vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq. Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale ka përpiluar kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit M.K, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Prokurorja Deniona Katro, në datën 7.4.2014 ka paraqitur konkluzionet përfundimtare sipas kërkesave të nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale, në seancën gjyqësore të zhvilluar në ngarkim të të pandehurit M.K. Në përfundim të gjyqimit, prokurorja ka kërkuar “Deklarimin fajtor të të pandehurit M. K, për veprën penale ‘drejtim automjeti në mënyrë të parregullt’, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim etj.”.

Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Prokurorja ka paraqitur qartësisht rrethanat e faktit dhe provat e administruara. Akti është i arsyetuar. Rezulton se konkluzioni i prokurores, në aspektin arsyetues, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.4.2014, ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit M.K, për veprën penale ‘drejtim automjeti në mënyrë të parregullt’, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim”. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.5.2014, pas shqyrtimit të ankimit të palëve në gjykim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit me ndryshim pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke i caktuar 100 orë pune për interes publik.

**Dosja 5** – kërkesë “Për gjykimin e çështjes”, datë 28.10.2013, përgatitur nga prokurorja Deniona Katro, subjekt rivlerësimi, regjistruar në datën 23.5.2013, me të pandehur A. Sh, akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 28.10.2013.

Mbështetur në nenin 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori Deniona Katro, më 28.10.2013 ka marrë vendim për dërgimin e çështjes në gjyq.

Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, ka përpiluar kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit A.Sh, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Në gjykimin e çështjes, në datën 14.1.2014 i dëmtuari N.Gj ka hequr dorë nga ankimi, bazuar në nenin 286/2 të Kodit të Procedurës Penale, duke kërkuar pushimin e gjyqimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.1.2014, ka vendosur pushimin e gjyqimit të çështjes, për faktin se i dëmtuari ka hequr dorë nga ankimi në seancën gjyqësore.

### **Të dhëna nga burime arkivore**

Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, si dhe burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se subjekti Deniona Katro:

- Nuk ka pasur masa disiplinore.
- Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.
- Ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka materiale hetimore të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para.

- Ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka ankesa apo kallëzime penale të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

### **Rivlerësimi i kryer nga Komisioni**

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe të dhënave nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

### **Aftësitë profesionale**

Subjekti i rivlerësimit, prokurore Deniona Katro, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tre aktet procedurale ligjore të paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Në shumicën e rasteve analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

Konstatohet se ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. \*\*\*, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore” (dosjet 4 dhe 5). Aktet e përpiluara prej saj janë administruar në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrit.

Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se prokurorja Deniona Katro është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj.

Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokuroren Deniona Katro, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurore Deniona Katro, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

## **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Nga vlerësimet e punës së subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të kryera nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

## **DENONCIME**

Për subjektin e rivlerësimit Deniona Katro nuk rezultuan ankesa apo denoncime të mbërritura pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive dhe konsiderohet “e aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.**

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Deniona Katro ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, referuar gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,



## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Deniona Katro, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.10.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
Kryesuese

**Roland ILIA**  
Relator

**Pamela QIRKO**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*